

Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan

Data:12.10.2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Shërbim i ruajtjes dhe shoqerimit te vlerave monetare per Njesine e Kordinimit Elbasan FSHU sha” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **79711000-1**, ,
Shebim me roje private

VLERA E FONDIT LIMIT: 27.554.250 (njetzet e shtate milion e peseqind e pesedhjete e kater mije e dyqind e pesedhjete) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros për te tre viteve te fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros ne te pakten njerin prej tre viteve, te jete jo me e vogel se 100 % të fondit total limit te mareveshjes kuader.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

OE ofertues duhet te kete kapacitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera minimale e xhiros ne tre vitet e fundit financiare te jete ne masen 100% e fondit te marreveshjes kuader

2.2.2. Kopje te vërtetuar te bilanceve, te audituara nga ekspertet kontabël te licencuar, te konfirmuara nga autoritetet përkatëse te Administratës Tatimore, te tre viteve te fundit (2020, 2021, 2022) ku te pakten ne dy bilancet e njepasnjeshme, nuk ka raport negative ndermjet aktivitet dhe pasivitet. Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, duhet te paraqitet nga Operatori Ekonomik vetem ne rastet kur jane ne kushtet e percaktuara nga neni 41, germa 'c' e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. *Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40 % të vlerës së fondit total limit të Marreveshjes Kuader, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*
 - a. *Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
 - b. *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke pasur parasysh se shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimi të vlerave monetare është një shërbim shumë i rëndësishëm, është parë e arsyeshme që operatori ekonomik duhet të ketë eksepriencë të mëparshme për të garantuar shërbimin e kërkuar dhe për të vërtetuar aftësitë e tij.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë si më poshtë:

- a) *Liçencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014, në kategorinë I.3.B.*
- b) *Certifikate e titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhezimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, në kategorinë I.3.B.*
- c) *Certifikate e drejtuesit teknik, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e shërbimit privat të sigurisë fizike, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhezimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, në kategorinë I.3.B.*
- d) *Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhezimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, në kategorinë I.3.B, për të paktën 8 (tete) punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan.*
- e) *Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për “Radiokomunikimin” konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit operatori ekonomik të jete liçencuar për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe radioalarm në zonat ku ndodhen objektet ku do të kryhet shërbimi.. Distanca e mbulimit me radiokomunikim dhe radioalarmi duhet të jete jo më pak se 40 kilometra, referuar distancave në vije ajrore nga qendra e qarkut drejt qyteteve në të cilat do të kryhet shërbimi.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit.75/2014“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Ne lidhje me kerkese qe distanca e mbulimit me radiokomunikim dhe radioalarm duhet te jete jo me pak se 40 km AK ka argumentuar se kjo kerkese eshte mbeshtetur ne nenin 77, te ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik, neni 41, pika 4, germa a te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, si dhe ligjit 75/2014 “Per sherbimin privat te sigurise fizike” si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Me ane te ketij kriteri kerkohej qe operatoret ekonomike te deshmojne se disponojne autorizimet e nevojshme te leshuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare per shfrytezimin e frekuencave per radiokomunikim dhe radioalarm, pasi vec sherbimit me punonjes sherbimi(roje fikse) te cile e kane te domosdoshme komunikimin me qendren e kontrollit, shrbimi do te kryhet dhe me sisteme sinjalizimi (radioalarmi) dhe vezhgimi.

Ne vijim te argumentimit te bere AK thekson se kjo distance eshte vendosur referuar distancave ne vije ajrore nga qendra e qarkut drejt qyteteve ne te cilat do te kryhet sherbimi

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **kapacitetet teknike dhe personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1. Operatori Ekonomik te kete Qender Kontrolli. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, te jete leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Elbasan, ne baze te nenit 22 te Ligjit nr. 75/2014 "Per sherbimin Privat te sigurise fizike" dhe Udhezimit te Ministrit te Brendshem nr.130, date 05.03.2018 "Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise".*
- 2. Operatori Ekonomik te paraqes Vërtetim Performance nga Drejtoria Vendore e Policise Elbasan, leshuar brenda 30 diteve nga data e hapjes se ofertave, ne te cilen pasqyrohet informacioni i mëposhtëm :*
 - a. Për numrin e punonjesve të shërbimit të çertifikuar per jo më pak se 8 (tete) punonjës shërbimi, nenkategoria I.3.B.*
 - b. Qe ka jelek anti plumb, radiokomunikimi, hekura lidhes, shkopinj gome.*
 - c. Nuk ka masë administrative per operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas percaktimeve te kreut V, te Ligjit nr.75/2014.*
 - d. Nuk ka ngjarje te ndodhura.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligji 75/2014“Për shërbimin privat të sigurisë fizike” .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në lidhje me kërkesën për lëshimin e vërtetimit jo më parë se 30 ditë para hapjes së ofertave, AK ka argumentuar se me anë të këtij kriteri (vërtetimi i performancës nga DVP Elbasan) kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë kërkesat lidhur me stafin (nurmën e punonjësve), kualifikimet dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Kërkesa që vërtetimi i performancës të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave, është në përputhje me nenin 20 dhe nenin 24, gërma “e” të Ligjit nr. 75.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë” dhe ka për qëllim marrjen e informacionit sa më aktual lidhur me këtë performancë. Ky kriter gjithashtu bazohet edhe në Udhëzimin Nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V, gërma “B”, pika 11, në të cilin përcaktohet se : “Vlerësimi i performancës për veprimtarinë e SHPSF-së bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë mbi bazën e kriterëve të përmbushjes së detyrës dhe konstatimeve për shkeljet administrative. Një kopje e vlerësimit të performancës dërgohet në Drejtorinë e Rendit Publik dhe një kopje u jepet subjekteve të SHPSFve, kur kërkohet nga ana e tyre”.

Gjithashtu AK argumenton në vijim se referuar dispozitave të sipërcituara vërtetimi i performancës mund të merret në çdo kohë nga operatorët ekonomikë nuk ka pagesë dhe nuk ka afat për marrjen e tij. AK ka caktuar afatin 30 ditor për arsye që vërtetimi të jetë sa më i fundit.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 10 persona**, 8 punonjës shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- a) *Gjithashtu OE duhet të paraqes Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj, 8 punonjës shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.*

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezmin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me orinjalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve, 2 per cdo eskort, është përcaktuar ne baze te Udhezimit nr.130, date 03.05.2018.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- a) *Operatori ekonomik duhet të disponoje të paktën 4 (kater) mjete të blinduara ne pronesi me norme blindimi sipas Udhezimit te Ministrit te Brendshem nr.130, date 05.03.2018, minimalisht BR3. Pronësia e automjeteve te vertetohet duke paraqitur, Autorizim leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise, lejen e qarkullimit te tyre, siguracion te vlefshem, akt kolaudimi te vlefshem dhe taksa.*

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezmin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me orinjalin.

- b) *Operatori Ekonomik duhet të vertetoje se disponon ne pronesi jo me pak se 8 (tete) arme zjarri krahu te Kategorise 1.3 B. Per te vertetuar kete duhet te paraqese:*
- 1. Autorizim per blerje arme zjarri Kategoria 1.3 B, leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise.*
 - 2. Kontrate shitblerje arme me nje shoqeri te licensuar per shitblerje armesh shoqeruar me numrin serial per secilen arme.*
 - 3. Faturat tatimore.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ne baze te Ligjit nr.75/2014 “Per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike” dhe Udhezimit nr.130, date 05.03.2018, transporti i vlerave monetare behet me mjete te blinduara, te autorizuar per kryerjen e ketij sherbimin me autorizim perkates nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit. Numri 4 i mjeteve te blinduara eshte percaktuar ne baze te numrit te eskortave te percaktuara ne shtojcen 7 te Dokumentave te Tenderit “Formulari i Termave te References”.

Kriteri per pronesine e armeve (te gjata) bazohet ne nenin 7 e vijues te Ligjit 74/2014 “Per armet” si dhe nenet 32, 33, 34, 35 te Ligjit 75/2014 “Per sherbimin privat te sigurise fizike”. Numri i armeve 8 te gjata eshte percaktuar numrit te rojeve 8, qe do te kryejne sherbimin te ndare ne 5 eskorta.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur (preventiv për një rojë në muaj). Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin e ofertës duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (si p.sh.: pagesa bazë, shtesat mbi pagesën II, sigurimet shoqërore...etj). Ofertat që nuk respektojnë kërkesat ligjore do të konsiderohen nën koston ligjore dhe do të skualifikohen.

NJESIA E PROKURIMIT